



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kvalitetu, standardima i uspjehu

Rezultatet përmbledhëse të vlerësimit nga pyetësi "Studenti Mësimdhënësin"

Semestri veror, 2024/25

1. Qëllimi i vlerësimit

Realizimi i këtij vlerësimi ka për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, në mënyrë që të arrijmë të identifikojmë sfidat e mundshme në lidhje me përmbushjen e objektivave mësimore, dhe të bëjmë përpjekje për t'i larguar ato.

2. Procesi i vlerësimit


Ashtu siç është e paraparë në kalendarin e aktiviteteve, në fund të secilit semestër, studentët plotësojnë pyetësin "Studenti – Mësimdhënësin" për të vlerësuar lëndën dhe profesorin e lëndës. Procesi i vlerësimit në të pesë njësitë akademike, për semestrin veror 2024/2025, ka filluar me datë 26 maj dhe ka zgjatë deri me 6 qershor. Vlerësimi është bërë për profesorët dhe asistentët e secilës lëndë të ligjruar në semestrin veror të vitit akademik 2024/25. Gjatë kësaj periudhe janë vlerësuar 137 staf akademik, prej tyre: 85 staf të rregullt dhe 52 staf të angazhuar.

Këtë semestër, plotësimi i pyetësorit është realizuar përmes sistemit SEVC, gjatë periudhës së paraqitjeve të provimeve, për profesorët dhe asistentët e të pesë njësive akademike. Para fillimit të procesit të vlerësimit, i gjithë stafi akademik dhe studentët janë njoftuar për fillimin e procesit. Studentët janë njoftuar edhe me rregullat e përgjithshme të këtij procesi, duke i garantuar ata se pyetësorët janë anonim dhe se ata mund të shprehin lirshëm atë që mendojnë për secilin mësimdhënës dhe lëndë të vlerësuar. Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, të dhënat janë mbledhur dhe përpunuar nga Zyra qendrore për sigurim të cilësisë dhe vlerësim në nivel universiteti, si dhe nga Koordinatorët/Zyrtarët e cilësisë për njësi akademike. Raportet përmbledhëse janë analizuar nga Komisionet për Sigurim të Cilësisë në nivel të njësive akademike dhe nga Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim në nivel qendror. Bazuar në gjetjet nga rezultatet e vlerësimit, janë dhënë rekomandimet për përmirësim.

3. Rezultatet e vlerësimit


1. Në pyetjen ***“A e keni pranuar nga mësimdhënësi literaturën e kësaj lënde”***, shumica e studentëve, 6170 ose rreth 90%, kanë deklaruar se e kanë pranuar literaturën nga mësimdhënësi, çka tregon për një angazhim të mirë dhe transparencë në shpërndarjen e materialeve mësimore.

Ndërkohë, një përqindje më e vogël, 655 ose rreth 10%, janë deklaruar se nuk e kanë pranuar, gjë që mund të sinjalizojë mungesë komunikimi ose shpërndarje jo të njëtrajtshme të materialeve midis grupeve të studentëve (grafiku 1).



Grafiku 1

2. Në pyetjen ***“Në çfarë forme e keni pranuar literaturën”***, nga të dhënat shihet se forma më e zakonshme e shpërndarjes së saj është përmes platformës “SEMS”, me 3396 ose rreth 57.7% të studentëve që kanë raportuar se e kanë marrë literaturën në këtë mënyrë. Një përqindje e konsiderueshme, 2151 ose rreth 36.6%, e kanë pranuar literaturën përmes “e-mailit”, çka tregon se mësimdhënësit përdorin edhe kanale alternative për shpërndarjen e materialeve. Vetëm 657 ose rreth 11.2% e studentëve e kanë marrë literaturën në “bibliotekë”, duke sugjeruar përdorim më të kufizuar të burimeve fizike krahas atyre digjitale. Ndërsa 621 ose rreth 10.6% e studentëve kanë deklaruar se “nuk u është ofruar fare” literaturë, çka mund të konsiderohet si mangësi që kërkon vëmendje për të siguruar qasje të barabartë në materialet mësimore (grafiku 2).




Grafiku 2

3. Në pyetjen ***“A ishte literatura e kësaj lënde e kuptueshme”***, rezultatet tregojnë se shumica e studentëve, 6061 ose rreth 87.2%, e kanë vlerësuar literaturën e lëndës si të kuptueshme, gjë që tregon se materialet e përdorura janë të përshtatshme dhe të lehta për t’u kuptuar.

Ndërkaq, 348 studentë ose rreth 5.0% kanë deklaruar se literatura nuk ishte e kuptueshme, ndërsa 416 studentë ose 6.0% kanë shprehur mungesë qëndrimi të qartë, duke u përgjigjur me opsionin *“nuk e di”*.


Në përgjithësi, rezultati reflekton një perceptim shumë pozitiv për cilësinë dhe qartësinë e literaturës. Megjithatë, sugjerohet që për grupin e vogël të studentëve që kanë hasur vështirësi, të ofrohen materiale shtesë ose shpjegime plotësuese, me qëllim rritjen e qasjes dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes mësimore (grafiku 3).



Grafiku 3


4. Në pyetjen **“A e keni pranuar nga mësimdhënësi literaturën e kësaj lëndë”** Rezultatet tregojnë se shumica e studentëve, 5633 ose rreth 81.5%, deklarojnë se “janë informuar qartë për mënyrën e vlerësimit” nga mësimdhënësi. Kjo tregon se procesi i komunikimit të kriterëve të vlerësimit është përgjithësisht i qartë dhe i kuptueshëm për studentët. Megjithatë, 931 apo 13.5% e të anketuarve theksojnë se janë informuar “vetëm pjesërisht”, gjë që sinjalizon nevojën për përmirësim në mënyrën e shpjegimit të kriterëve të vlerësimit. Një përqindje më e vogël, 261 apo 3.8%, deklarojnë se “nuk janë informuar fare”, çka sugjeron se jo të gjithë mësimdhënësit ndjekin të njëjtat standarde në komunikimin e mënyrës së vlerësimit.

Në përgjithësi, rezultati mesatar prej 4.65 reflekton një nivel shumë të mirë të informimit të studentëve për këtë aspekt, por ekziston ende hapësirë për rritje të transparencës dhe konsistencës në gjithë procesin e vlerësimit (grafiku 4).



Grafiku 4


5. Në pyetjen **“A kanë qenë të qarta ligjëratat e shpjeguara nga mësimdhënësi”**, Nga gjithsej 6825 përgjigje, vihet re se shumica e studentëve, 5520 ose rreth **78.7%**, e kanë vlerësuar pozitivisht qartësinë e ligjëratave, duke treguar se mësimdhënësit kanë arritur ta përcjellin qartë përmbajtjen mësimore. Një përqindje më e vogël, 1004 ose rreth **14.3%**, kanë menduar se ligjëratat kanë qenë mesatarisht të qarta, ndërsa 301 ose rreth 4.3% kanë deklaruar se nuk kanë qenë të qarta. Kjo reflektohet edhe në vlerën mesatare prej 4.61, e cila tregon një nivel shumë të mirë të qartësisë në ligjëratat (grafiku 5).



Grafiku 5

6. Në pyetjen **“A ka zhvilluar mësimdhënësi aktivitete mësimore plotësuese (ushtrime, punë praktike, laboratorë, etj)”**, Nga gjithsej 6825 përgjigje, shumica e studentëve, 5373 ose rreth 76.9% vlerësojnë se mësimdhënësi ka zhvilluar “shumë aktivitete plotësuese” (ushtrime, punë praktike, laboratorë etj.), çka tregon një angazhim të lartë praktik në procesin mësimor. Rreth 1031 studentë ose 14.8%, mendojnë se aktivitetet janë zhvilluar “mesatarisht”, ndërsa 421 ose rreth 6.0% deklarojnë se “nuk janë zhvilluar fare aktivitete”.


Vlera mesatare prej 4.56 e mbështet këtë rezultat pozitiv, duke theksuar rëndësinë e vazhdimësisë së përfshirjes së tyre në procesin mësimor (grafiku 6).



Grafiku 6

7. Në pyetjen **“A i ka ligjëruar mësimdhënësi temat e njëjta ashtu siç janë paraparë në syllabus”**, Rezultatet tregojnë se shumica e studentëve e vlerësojnë se mësimdhënësi ka ndjekur tematikën e syllabus-it plotësisht. Konkretisht, 5598 studentë ose rreth 82.9%, kanë zgjedhur opsionin “Po, plotësisht”. Një pjesë më e vogël e studentëve, 881 studentë ose rreth 13.0%, e vlerësojnë se temat janë trajtuar “mesatarisht” sipas syllabus-it. Ndërsa, 346 studentë ose rreth 5.1%, kanë menduar se temat nuk janë trajtuar siç ishte parashikuar.


Mesatarja e përgjigjeve prej 4.65 tregon një përputhje të qëndrueshme midis përmbajtjes së ligjëratave dhe syllabus-it, duke sinjalizuar një zbatim të mirë të planifikimit mësimor (grafiku 7).



Grafiku 7


8. Në pyetjen **“A ka mbajtur mësimdhënësi konsultime gjatë semestrit”**, 5747 studentë ose rreth 83.2%, janë deklaruar se mësimdhënësi ka mbajtur konsultime gjatë semestrit, gjë që tregon një nivel të lartë të angazhimit dhe disponueshmërisë së mësimdhënësit. 568 studentë ose rreth 8.2%, nuk kanë pasur mundësi të përfitojë nga konsultimet, që mund të reflektojë mungesë komunikimi ose organizimi në disa raste. 510 studentë ose rreth 7.4%, nuk kanë pasur informacion të mjaftueshëm për konsultimet, që sugjeron se informimi për këto mund të përmirësohet.

Në përgjithësi, mbi 80% e studentëve kanë pasur konsultime, që është një tregues pozitiv, por është e nevojshme të punohet për të përfshirë edhe grupin më të vogël që nuk ishte i informuar ose nuk ka pasur mundësi të ndjekë konsultimet (grafiku 8).



Grafiku 8


9. Në pyetjen **“A ka qenë i gatshëm mësimdhënësi për sqarime dhe shpjegime shtesë, gjatë orarit të konsultimeve”**, 5556 studentë ose rreth 81.8%, janë përgjigjur me **“Po, ka qenë shumë i gatshëm”**. Ky është një rezultat i lartë, duke treguar se shumica e studentëve e kanë vlerësuar mësimdhënësin si shumë të gatshëm për shpjegime shtesë. Ndërsa 950 studentë ose rreth 14.0%, janë përgjigjur me **“Mesatarisht i gatshëm”**. 319 studentë ose rreth 4.7%, janë përgjigjur me **“Jo, nuk ka qenë i gatshëm”** një përqindje shumë e vogël, që tregon se pak studentë nuk kanë ndjerë mbështetje gjatë konsultimeve. Në përmbledhje, rezultatet tregojnë se mësimdhënësi ka qenë përgjithësisht shumë i gatshëm për sqarime dhe shpjegime shtesë gjatë konsultimeve, me një përqindje të vogël të studentëve që e kanë vlerësuar këtë më pak (grafiku 9).



Grafiku 9


10. Në pyetjen ***“A ka qenë mësimitdhënësi bashkëveprues gjatë ligjëratave/ushtimeve”***, 5573 studentë ose rreth 81.8%, e kanë vlerësuar që mësimitdhënësi është *“shumë bashkëveprues”*, duke treguar se shumica e studentëve kanë një komunikim aktiv dhe një mjedis mësimit ku mund të bëjnë pyetje, të marrin shpjegime dhe të angazhohen në diskutime. 966 studentë ose rreth 14.2%, e kanë perceptuar bashkëveprimin si *“mesatar”*, që tregon se një pjesë e studentëve ndoshta kanë pasur më pak mundësi të ndërvepronin ose bashkëpunimi nuk ka qenë gjithmonë në nivelin maksimal. Ndërsa 286 studentë ose rreth 4.2%, e kanë konsideruar që mësimitdhënësi *“nuk është bashkëveprues”*.

Mesatarja e përgjigjeve prej 4.64 tregon se studentët vlerësojnë në masë të madhe bashkëpunimin e mësimitdhënësit gjatë ligjëratave dhe ushtimeve. Ky rezultat reflekton një nivel të lartë të ndërveprimit në klasë, me mundësi për përmirësim në drejtim të përfshirjes së plotë të të gjithë studentëve (grafiku 10).



Grafiku 10


11. Në pyetjen ***“A u ka ofruar mësimitdhënësi shembuj praktik nga ajo çka është shpjeguar në teori”***, Me *“Po”* janë përgjigjur 5494 studentë ose rreth 80.5%. Kjo tregon se shumica e studentëve kanë vlerësuar pozitivisht angazhimin e mësimitdhënësit në lidhjen e teorisë me praktikën, gjë që është tregues i një qasjeje moderne dhe efikase në mësimitdhënie. *“Mesatarisht”* kanë deklaruar 1013 studentë ose rreth 14.8%, që nënkupton se në disa raste janë ofruar shembuj praktikë, por jo në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjithë ligjëratave. Ky grup tregon për nevojën që mësimitdhënësi të shtojë elementet praktike për të arritur një balancë më të mirë ndërmjet teorisë dhe praktikës. *“Jo”* janë përgjigjur 318 studentë ose rreth 4.7%. Kjo përqindje është relativisht e ulët, por tregon se duhet adresuar për të siguruar përfshirje më të plotë të studentëve në procesin mësimit (grafiku 11).



Grafiku 11

12. Në pyetjen ***“A e ka nxitur mënyra e ligjërimit të mësimeve interesimin për ligjëratë”***, 5376 studentë ose rreth 76%, kanë deklaruar se mënyra e ligjërimit të mësimeve *“ka nxitur shumë interesim”*. Kjo tregon se shumica e studentëve janë të motivuar dhe të angazhuar gjatë ligjëratave, falë stilit të prezantimit të mësimeve. 1078 studentë ose rreth 15%, mendojnë se interesimi është *“nxitur në mënyrë mesatare”*, që sugjeron se për këtë grup, mënyra e ligjërimit mund të ketë qenë efektive, por jo gjithmonë në nivel të lartë. Ndërsa 371 studentë ose rreth 5%, kanë vlerësuar se mësimeve *“nuk ka nxitur interesim”* për ligjëratë, duke treguar një pakicë që nuk e ka gjetur ligjërimin tërheqës ose motivues.

Vlera mesatare prej 4.56 tregon një tendencë të përgjithshme pozitive në vlerësimin e mënyrës së ligjërimit, duke lënë hapësirë për reflektim dhe përmirësim të vazhdueshëm në aspektin e angazhimit të studentëve (grafiku 12).



Grafiku 12

REKOMANDIMET NGA KËSHILLI PËR MENAXHIM TË CILËSISË DHE VLERËSIM

- Rekomandohen dekanët e njësive akademike që të marrin masa ndaj mësimeve për të cilët janë dhënë komente me karakter kritik nga studentët.
Afati i implementimit: Janar 2026!
- Rekomandohen personeli akademik që të ofrojë feedback-ut individual dhe mbështetje të vazhdueshme për përparimin e studentëve:
I menjëhershëm!